

20160270721

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN PUBLIK

Neni 1

Në Ligjin për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14 dhe 199/14), në nenin 17 paragrafi (5) fjalët: "përveç për institucione me më pak se 15 të punësuar, për të cilët mund të jenë të sistematizuar në më së shumti dy vende pune" zëvendësohen me fjalët: " përveç në institucione me më pak se 30 të punësuar, në të cilat mund të jenë të sistematizuar në 50 vende pune, nëse ka rritje të kompetencave të institucioneve në pajtim me ligjin kur numri në vendet e punës përcaktohet në pajtim me analizën funksionale".

Neni 2

Në nenin 18 paragrafi (1) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "i cili nëpërmjet sistemit të informacionit për menaxhim me resurse njerëzore (në tekstin e më poshtëm: SIMRNJ) e vendos edhe në formë elektronike e mban Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës do të mundësojë qasje te SIMRNJ në të gjitha institucionet në sektorin publik nëpërmjet dorëzimit të emrit shfrytëzues dhe fjalëkalimi për personin e autorizuar nga funksionar i cili udhëheq me institucionin."

Neni 3

Në nenin 19 pas paragrafit (4) shtohen tre paragrafë të rinj (5), (6) dhe (7), si vijojnë:

"(5) Funksionari i cili udhëheq me institucionin është i obliguar të autorizojë së paku një person për menaxhim me SIMRNJ, kurse nëse bëhet fjalë për institucion të sapoformuar në afat prej dy muajsh nga dita e themelimit të institucionit dhe për atë në afat prej pesë ditësh e njofton Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(6) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës është e obliguar në afat prej pesë ditësh nga pranimi i njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni në adresë elektronike të personit të autorizuar nga institucioni t'i dorëzojë emër shfrytëzuesi dhe fjalëkalim për qasje te SIMRNJ.

(7) Personi i autorizuar nga paragrafi (5) i këtij neni është i obliguar t'i vendosë, respektivisht kompletojë të dhënat në Regjistrin e SIMRNJ j, më së voni një muaj nga dita e pranimit të emrit shfrytëzues dhe fjalëkalimit nga paragrafi (6) i këtij neni, si dhe ta azhurnojë çdo ndryshim të ndodhur të të dhënave në afat prej 10 ditësh nga ndodhja e tij."

Neni 4

Në nenin 23 paragrafi (3) në alinën 4 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje dhe shtohet alineja e re 5, si vijon:

"- kujdesi për fëmijë me probleme në zhvillim dhe nevoja të veçanta arsimore dhe".

Në paragrafin (6) fjalët: "alineja 5" zëvendësohen me fjalët: "alinetë 5 dhe 6".

Në paragrafin (7) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "përveç në raste nga paragrafi (3) alinetë 5 dhe 6 të këtij neni për të cilat zbatohen dispozitat nga sfera e mbrojtjes shëndetësore, sigurimi invalidor ose mbrojtja sociale."

Neni 5

Në nenin 46 në fjalinë hyrëse fjalët: "7.500 deri 15.000" zëvendësohen me fjalët: "2.000 deri 3.000", kurse pas fjalës "shqipton" shtohen fjalët "për kundërvajtje".

Në alinën 1 fjalët: " në kundërshtim të" zëvendësohet me fjalët: "në pajtim".

Pas alinesë 1 shtohet aline e re 2, si vijon:

"- nuk autorizon së paku një person për menaxhimin me të dhënat në SIMRNJ ose për këtë nuk e njofton Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, në pajtim me nenin 19 paragrafin (5) të këtij ligji,".

Në alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 11 dhe 12 të cilat bëhen aline 3, 4, 5, 6, 7, 12 dhe 13, fjalët: " në kundërshtim të" zëvendësohen me fjalët: "në pajtim".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 250 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar për menaxhim me SIMRNJ, nëse nuk i vendos, respektivisht nuk i kompletton të dhënat në Regjistrin në SIMRNJ në afat prej një muaji nga dita e pranimit të emrit shfrytëzues dhe fjalëkalimit për SIMRNJ, ose nuk e azhurnon çdo ndryshim të ndodhur të të dhënave në afat prej 10 ditësh nga ndodhja e tij, në pajtim me nenin 19 paragrafi (7) të këtij ligji."

Neni 6

Pas nenit 46 shtohen dy nene të reja 46-a dhe 46-b, si vijojnë:

"Neni 46-a

(1) Për kundërvajtje përcaktuar në nenin 46 të këtij ligji, inspektori administrativ për të punësuarit në sektorin publik nga neni 14 paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji respektivisht inspektori i punës për të punësuarit në sektorin publik nga neni 14 paragrafi (1) alinetë 3 dhe 4 të këtij ligji është obliguar kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Inspektori administrativ respektivisht i punës është i obliguar të mbajnë evidencë për urdhër pagesa të lëshuara kundërvajtëse dhe për epilogun e procedurave të ngritura

(3) Në evidencën nga paragrafi (2) i këtij neni grumbullohen, përpunohet dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, respektivisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i lëshohet dhe rezultati i procedurës

(4) Të dhënat personale nga paragrafi (3) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(5) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 46-b

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente."

Neni 7

Funksionari i cili udhëheq me institucionin është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të autorizojë së paku një person për të menaxhuar me SIMRNJ.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".